



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

**K.DH.SH.II.nr.38/24**

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS** - Dhoma e Shkalles se Dytë, me gjyqtarin Faton Bajrami, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit Kompania Kosovare per Furnizim me Energji Elektrike, me seli në Prishtinë, kundër debitorit Spar Kosova J.S.C – J.R. me numer personal ... dhe adrese ne Ferizaj, duke vendosur lidhur me ankesën e ushtruar të kreditorit, kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhoma e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike KPPP.nr.2038/22 të datës 30.10.2023, me datën 05.03.2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**REFUZOHET** e pabazuar ankesa e kreditorit Kompania Kosovare per Furnizim me Energji Elektrike, me seli në Prishtinë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhoma e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike KPPP.nr.2038/22 të datës 30.10.2023, **VËRTETOHET**.

**A r s y e t i m**

Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhoma e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e ankimuar KPPP.nr.2038/22 të datës 30.10.2023, e ka pranuar si të bazuar prapësimin e debitorit Spar Kosova J.S.C – J.R. me numer personal ... dhe adrese ne Ferizaj, ashtu që Urdhri Përmbarimor P.nr.943/21, i lejuar më datë 03.12.2021, nga Përmbaruesi Privat Bardh Tasholli, SHFUQIZOHET.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka paraqitur ankesë kreditori ushtruar, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore dhe përmbarimore, për shkak të vërtetimit te gabuar te gjendjes faktike dhe aplikimit te gabuar te se drejtës materiale, me propozim që gjykata e shkalles se dytë ta aprovoj këtë ankesë dhe ta refuzoj prapësimin e debitorit.

Debitori nuk ka ushtruar përgjigje në ankesë.

Dhoma e Shkalles se Dytë e Gjykatës Komerciale, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të dispozitës së nenit 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) e lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore (LPP), gjeti se:

- **Ankesa e kreditorit është e pabazuar.**

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori me date 03.12.2021, ka paraqitur propozim për përmbardim ndaj debitorit, ku përmbarduesi privat Bardh Tasholli duke vepruar sipas propozimit te kreditorit me urdhrin përmbardimor P.nr.943/21 të datës 05.02.2021, me të cilin ka lejuar përmbardimin, mbi bazën e dokumentit të besueshëm, ekstraktit nga librat afariste DFE 9041328 duke e obliguar debitorin që në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij urdhri t'i paguaj kreditorit borxhin prej 1,593.32 €, si dhe shpenzimet e procedurës përmbardimore.

Kundër urdhrin përmbardimor debitori, brenda afatit ligjor ka paraqitur prapësim me të cilin e ka kundërshtuar urdhrin për lejimin e përmbardimit, me arsyetim se ekstrakti mbi bazën e te cilit është lejuar përmbardimi nuk është autentik, ne te nuk është saktësuar detyrimi për përmbushje, e as periudha kohore te cilës i referohet, me te j ka kundërshtuar me arsyetimin se pala debitorë ka përmbushur tere prestimin e saj për periudhën kontraktuese. Për këto arsye, gjykatës i ka propozuar që ta shfuqizoj urdhrin për lejimin e përmbardimit, ndërsa të obligohet kreditori që debitorit t'ia paguaj shpenzimet procedurale në emër të prapësimit, në vlerë sipas rregullores mbi tarifate e avokatëve.

Kreditori, në përgjigje në prapësim ka theksuar se pretendimet e debitorit janë të pabazuara dhe kane për qëllim zvarritjen e procedurës. Prandaj, gjykatës i ka propozuar që ta refuzoj prapësimin e debitorit si të pabazuar, ndërsa urdhri përmbardimor të mbetet në fuqi.

Gjykata e shkallës së parë pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes në prapësim të kreditorit, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbardimore, (në tekstin e mëtejme: "LPP") gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar dhe se urdhri përmbardimor duhet të anulohet, për shkaket si në vijim: Sipas nenit 38, paragrafi 1 dhe 2 të LPP-së, Propozimi për përmbardim duhet ta përmbajë kërkesën për përmbardim në të cilën do të tregohet dokumenti përmbardimor origjinal apo kopje e vërtetuar, apo dokumenti i besueshëm në bazë të cilit kërkohet përmbardimi, kërkuesi i përmbardimit dhe debitori, adresa e vendbanimit – vendqëndrimit apo selisë afariste të kreditorit dhe të debitorit, kredia që kërkohet të realizohet, si dhe mjeti nëpërmjet cilit duhet kryer përmbardimi, objekti i përmbardimit po qe se është i njohur, si dhe të dhënat e tjera që janë të nevojshme për zbatimin e përmbardimit. 2. Në rast se propozimi për përmbardim nga paragrafin 1. i këtij neni nuk përmban shënime e kërkua dhe numrin personal identifikues apo numrin e regjistrimit të biznesit të debitorit, organi përmbardues do të veprojë sipas dispozitave të nenit 102 të Ligjit të Procedurës Kontestimore.

Gjykata e shkallës së parë duke ju referuar dispozitave të cekura si më lartë, gjeti se urdhri mbi lejimin e përmbardimit është lejuar në kundërshtim me dispozitën nga neni 38, paragrafi 1, ngase në propozim përmbardim kreditori nuk i ka treguar të dhëna e nevojshme në drejtim të identifikimit të debitorit, përkatësisht propozimi për përmbardim është ushtruar ndaj Spar Kosova J.S.C – J.R. me numer personal ... duke mos treguar të dhënat e tjera të debitorit, si dhe duke e lënë te paqarte se borxhi i krijuar a është detyeim i biznesit – personit juridik apo personit fizik po ashtu pa treguar numrin e biznesit apo identifikues të debitorit, nuk është i mjaftueshëm për identifikimin e saktë të debitorit. Veç kësaj, nga shkresat e lëndës rezulton se kreditori ka kërkuar lejimin e urdhrin ndaj debitorit mbi bazën e dokumentit të besueshëm – ekstraktit nga librat afariste, duke e

përfshirë borxhin në mënyrë kumulative edhe pse kemi të bëjmë me kërkesa suksesive. Andaj, si rezultat i këtyre të metave, propozimi për përmbarrim nuk i plotëson kushtet nga neni 38 i LPP-së.

Në anë tjetër, sipas dispozitës nga neni 43, paragrafi 4 të LPP-së, përcaktohet se “Në lidhje me ankesën që ngrehë kundërshtimin ndaj urdhrin të përmbarrueshmërisë së nxjerrë nga përmbarruesi privat, Gjykata që kryen rishikimin e procedurës së përmbarrimit rishikon nëse janë plotësuar kushtet për nxjerrjen e atij urdhri nga përmbarruesi privat. Nëse Gjykata përcakton se nuk janë plotësuar kushtet për nxjerrjen e urdhrin për përmbarrim nga përmbarruesi privat, Gjykata shfuqizon urdhrin me vendim”. Andaj, nga të lartcekurat gjykata gjen se në rastin konkret urdhri mbi lejimin e përmbarrimit është nxjerrë pa u plotësuar kushtet për lejimin e tij, ngase në propozim për përmbarrim nuk janë paraqitur të dhënat e nevojshme për identifikimin e debitorit, si dhe nuk është bashkangjitur origjinali apo kopja e vërtetuar e dokumentit të besueshëm – faturës 91059, andaj i njëjti propozim përmban të meta në kuptim të nenit 38, paragrafi 1 të LPP-së, të cilat tani nuk mund të evitohen, ngase gjykata në fazën e procedurës sipas mjetit juridik, kufizohet vetëm në shqyrtimin e përshtatshmërisë së dokumentit mbi bazën e së cilit është lejuar urdhri si dhe ligjshmërinë e urdhrin. Andaj, duke qenë se urdhri përmbarrimor është nxjerr pa u plotësuar kushtet për lejimin e tij, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi duke shfuqizuar urdhrin përmbarrimor. Tutje vlerëson se të metat e theksuara si më lartë kanë mundur të evitohen nga organi përmbarrues, përkatësisht nga përmbarruesi privat, në kuptim të nenit 38, paragrafi 2 të LPP-së,

Dhoma e Shkallës së Dytë e Gjykatës Komerciale vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, prandaj konkludimin e gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranohet edhe Gjykata Komerciale dhoma e shkallës së dytë, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 1 dhe 2 të LPK-së, dhe se drejtë është vërtetuar gjendja faktike, kështu që mund të hetohet dhe vlerësohet ligjshmëria e tij, shkelje të cilat gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Komerciale – Dhoma e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbarrimore kur e ka aprovuar prapësimin e debitorit, ngase edhe sipas vlerësimit të kësaj gjykate me shikimin në shkresat e lëndës shihet qarte se si dokument i besueshëm, për shkak se kreditori nuk i ka treguar të dhëna e nevojshme në drejtim të identifikimit të debitorit, përkatësisht propozimi për përmbarrim është ushtruar ndaj Spar Kosova J.S.C – J.R. me numer personal ..., duke mos treguar të dhënat e tjera të debitorit. Në vlerësimin e gjykatës, vetëm përshkrimi i debitorit, pa treguar numrin e biznesit apo identifikues të debitorit, nuk është i mjaftueshëm për identifikimin e saktë të debitorit. Veç kësaj, nga shkresat e lëndës rezulton se kreditori ka kërkuar lejimin e urdhrin ndaj debitorit mbi bazën e dokumentit të besueshëm – ekstraktit nga librat afariste, duke e përfshirë borxhin në mënyrë kumulative edhe pse kemi të bëjmë me kërkesa suksesive..

Andaj gjykata e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim në pajtim me dispozitat ligjore, prandaj përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranohet edhe gjykata e shkallës së dytë, me çka mbi bazën e këtyre rrethanave dhe fakteve kësaj gjykate i rezultoi se aktvendimi i ankimuar i nxjerrë nga gjykata e shkallës së parë është i drejtë i bazuar.

Më te drejt gjykata e shkalles se parë ka vlerësuar se kreditori ne rastin konkret nuk ka ofruar prova juridikisht te vlefshme në mbështetje te pretendimeve te tij.

Përndryshe në procedurën përbarimore bëhet realizimi direkt i mbrojtjes juridike të konstatuar në dokumentin përbarimor i cili përmban aktin juridik me të cilin vërtetohet ekzistimi i kërkesës dhe se nga ky dokument rrjedh e drejta e organit përbarues që sipas propozimit të kreditorit të caktoj dhe zbatoj përbarimin.

Kompetenca e Dhomës se Shkalles se Dytë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK lidhur me nenin 17 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS,  
Dhoma e Shkalles se Dytë  
K.DH.SH.II.nr.38/24, me datë 05.03.2024**

**Gjyqtari,  
Faton Bajrami**